



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

Rruga: "Durrësit", Nr. 23, AL- 1001, Tiranë – SHQIPËRI

www.mash.gov.al

Tel: 00 355 4 225 678

Nr. Prot.
Tiranë, 2007

UDHËZIM

Nr.40, datë 17.10.2007

PËR

NGRITJEN E FUNKSIONIMIT E BORDIT TË SHKOLLËS

Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr. 7952, datë 21.06.1995 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar", i ndryshuar

KREU I

MISIONI DHE DETYRAT E BORDIT

1. Bordi i shkollës ka si mision të sigurojë që shërbimi shkollor të kryhet sipas politikave arsimore kombëtare e lokale dhe interesave të komunitetit të shkollës.

2. Detyrat e bordit janë si më poshtë:

- a) Miraton planin afatmesëm të shkollës
- b) Miraton planin vjetor të shkollës
- c) Miraton buxhetin e shkollës (fondet publike, kontributet e komunitetit ose të donatorëve, të ardhurat nga veprimtaritë e shkollës)
- d) Miraton raportin vjetor të shkollës dhe raportin e saj financiar
- e) Miraton rregulloren e brendshme të shkollës
- f) Miraton kriteret shitesë të përzgjedhjes së drejtorit të shkollës dhe të mësuesve të saj
- g) Miraton kurrikulën në nivel shkolle
- h) Përpiqet të sigurojë kontribute të komunitetit, të biznesit dhe të qeverisë lokale në mbarëvajtjen e shkollës;
- i) Miraton projektet e bashkëpunimit me institucionet e tjera
- j) Miraton veprimtaritë që kryen shkolla për komunitetin (pas mësimi)
- k) Miraton hapjen ose mbylljen e shërbimeve të shkollës për të tretët

KREU II

PAVARËSIA PROFESIONALE

Bordi respekton pavarësinë profesionale të personelit shkollor. Bordi nuk ndërhyr në:

- a) Përzgjedhjet mësimdhënëse-mësimnxënëse të mësuesve;
- b) Vlerësimin e nxënësve.

KREU III

DREJTORI I SHKOLLËS

Drejtori i shkollës kundrejt bordit të shkollës ka për detyrë:

1. T'i paraqesë bordit për miratim planin zhvillimor katërvjeçar të shkollës;
2. T'i paraqesë bordit për miratim planin vjetor të shkollës;
3. T'i paraqesë bordit për miratim raportin vjetor të veprimtarisë së shkollës si dhe raportin financiar;
4. T'i paraqesë bordit për miratim rregulloren e brendshme të shkollës;
5. Të informojë periodikisht bordin për arritjet e nxënësve të shkollës;
6. T'i dorëzojë secilit anëtar të bordit një kopje të raportit të inspektimit;
7. T'i raportojë bordit për çështje të mbarëvajtjes së shkollës për të cilat kryetari i bordit i paraqet drejtorit kërkesë me shkrim.

KREU IV

PËRBERJA E BORDIT

1. Bordi i një shkolle përbëhet nga prindër të nxënësve dhe nxënës të asaj shkolle, përfaqësues të komunitetit shkollor që nuk janë prindër të nxënësve të asaj shkolle (të jashtëm), përfaqësues të Drejtorisë Arsimore Rajonale/Zyrës Arsimore përkatëse, përfaqësues të qeverisë vendore përkatëse (bashki ose komunë), mësues të asaj shkolle.
2. Kur Drejtoria Arsimore Rajonale/Zyra Arsimore ose qeveria vendore (bashkia, komuna) mbulon një numër të madh shkollash, këta përfaqësohen në bord me të deleguarin e tyre, i cili, si rregull, duhet të jetë një pjesëtar i komunitetit shkollor.
3. Numri i anëtarëve të bordit varet nga numri i nxënësve të shkollës dhe përcaktohet nga tabela më poshtë:

Numri i nxënësve të shkollës	Numri i anëtarëve të bordit
< 300	7
[300; 999[	9
> 1000	11

4. Përbërja e bordit është si më poshtë¹:

¹ Nuk janë përfshirë përfaqësuesit e DAR/ZA dhe të qeverisë vendore.

Numri i nxënësve të shkollës	Shkolla bazë			
	Mësues	Prindër	Nxënës	Të jashtëm
< 300	1	2	1	1
[300; 999[	1	4	1	1
> 1000	1	4	2	2

Numri i nxënësve të shkollës	Shkolla e mesme			
	Mësues	Prindër	Nxënës	Të jashtëm
< 300	1	2	1	1
[300; 999[	1	3	2	1
> 1000	1	4	2	2

5. Nxënësit që mund të marrin pjesë në bord janë sipas kësaj radhe:
 - a) Presidenti i senatit të nxënësve.
 - b) Kryetari i senatit.
 - c) Një nxënës i propozuar nga senati.
6. Përfaqësues të prindërve në bordin e shkollës janë sipas kësaj radhe:
 - a) Kryetari i këshillit të prindërve të shkollës,
 - b) Prindër të tjerë që zgjidhen nga këshilli i prindërve të shkollës dhe që mund të jenë ose jo anëtarë të këtij këshilli.
7. Mësuesi, anëtar i bordit, zgjidhet me votim nga personeli mësimor i shkollës.
8. Përfaqësuesi i DAR/ZA emërohet nga drejtori i Drejtorisë Arsimore Rajonale/përgjegjësi i Zyrës Arsimore.
9. Përfaqësuesi i qeverisë lokale caktohet nga kryetari i bashkisë/komunës përkatëse.

KREU V

NGRITJA E BORDIT

1. Bordi ngrihet menjëherë pas ngritjes së qeverive të nxënësve, këshillave të prindërve të klasave dhe këshillit të prindërve të shkollës.
2. Veprimtaritë për ngritjen e bordit të ri të shkollës i drejton kryetari i bordit të mëparshëm.
3. Kur bordi krijohet për herë të parë, nismën e merr kryetari i këshillit të prindërve të shkollës.
4. Kryetari i bordit zgjidhet në mbledhjen e parë me shumicë votash.
5. Mbledhja e parë drejtohet nga anëtari me moshë më të madhe.
6. Kryetari i bordit zgjidhet një herë në katër vjet.
7. Mbledhja për shkarkimin e kryetarit të bordit zhvillohet kur këtë e kërkojnë të paktën katër anëtarë të bordit.
8. Mbledhja për shkarkimin e kryetarit të bordit mund të zhvillohet nëse në të marrin pjesë të paktën 3/5 e anëtarëve të bordit.
9. Votimi për shkarkim është i fshehtë.
10. Kryetari shkarkohet me votat e më shumë se gjysmës së pjesëmarrësve.

KREU VI

FUNKSIONIMI I BORDIT

1. Bordi mbledhet tre herë në vit në seanca të zakonshme dhe sipas rastit në seanca jashtë radhe.
Seancat jashtë radhe zhvillohen me nismën e kryetarit të bordit, me nismën e të paktën katër anëtarëve të bordit ose me kërkesën e drejtorit të shkollës që i drejtohet kryetarit të bordit.
2. Kryetari i bordit fton rregullisht drejtorin në mbledhjet e bordit dhe ka të drejtë të ftojë zëvendësdrejtorët, mësues, kryetarët e këshillave të prindërve të klasës, etj.
3. Vendimet, që kanë të bëjnë me emra njerëzish dhe me probleme financiare merren gjithnjë me votim të fshehtë.
4. Mbledhjet e bordit zhvillohen kur marrin pjesë jo më pak se 3/5 e anëtarëve të bordit. Në raste urgjencash mbledhja zhvillohet me shumicën e thjeshtë.
5. Kryetari i bordit i dorëzon drejtorit të shkollës raportin e mbledhjes së bordit. Në fund të çdo viti shkollor, kryetari i bordit u dërgon drejtorit të Drejtorisë Arsimore Rajonale /përgjegjësit të Zyrës Arsimore përkatëse dhe kryetarit të bashkisë/komunës një raport përmbledhës. Me vendim të bordit, kryetari i bordit mund t'i dërgojë raporte në çdo kohë drejtorit të Drejtorisë Arsimore Rajonale /përgjegjësit të Zyrës Arsimore përkatëse ose kryetarit të bashkisë/komunës. Institucioneve ose personave të veçantë, kryetari i bordit u dërgon kopje të vendimeve që lidhen me ta.
6. Vendimet e bordit firmosen nga kryetari, por nuk kanë nevojë për vulë.
7. Dokumentet e bordit mbahen dhe sigurohen në kasafortën e drejtorit, kundrejt inventarit përkatës.
8. Veprimtaria e bordit nuk paguhet.

KREU VII

ORGANIZIMI I BORDIT

1. Bordi zgjedh një sekretar dhe bën ndarjen e detyrave brenda tij.
2. Ai mund të ngrejë grupe pune edhe me persona që nuk janë në bord.

KREU VIII

PËRGJEGJËSIA PËR NGRITJEN E BORDIT

Përgjegjësinë për ngritjen e bordit të shkollës sipas procedurave të sipërpërmendura e ka Drejtoria Arsimore Rajonale ose Zyra Arsimore përkatëse.

KREU IX

DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo akt tjetër nënligjor që bie në kundërshtim me këtë udhëzim shfuqizohet.

Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Zëvendësministri për arsimin parauniversitar, Drejtoria e Kurrikulave, dhe çdo Drejtori Arsimore Rajonale dhe Zyrë Arsimore.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

GENC POLLO

M I N I S T E R

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
Konceptoi:	Suzana Tabaku, Fatmir Bezati		15.10.2007
Dr. i Drejtorisë:	Suzana Tabaku		15.10.2007
Dr. Juridike:	Rudin Baqli		.10.2007
Zëvendësministri	Halit Shamata		.10.2007
Sekretare e Përgjithshme:	Antonieta Luli		.10.2007